

Propozim

Në bazë të nenit 186 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Fl. zyr. MZ", nr. 2/18, 34/19 dhe 38/20), nenit 28 të Ligjit për veprimtaritë komunale ("Fl. zyr. MZ", nr. 55/16, 74/16, 2/18, 40/19, 66/19) dhe nenit 178 të Statutit të Komunës së Ulqinit ("Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës", nr. 48/19), Kuvendi i Komunës së Ulqinit, në mbledhjen e mbajtur, më ____ . ____ . _____, nxjerr

VENDIMIN

për dhënien e pëlqimit Qeverisë së Malit të Zi për sigurimin e ndërtimit dhe kryerjen e veprimtarive komunale të furnizimit publik me ujë dhe administrimin e ujërave të zeza në vendbanimin Krruç në Komunën e Ulqinit

Neni 1

Me këtë Vendim sigurohet ndërtimi i infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit, me të cilën do të sigurohet furnizimi i rregullt dhe i vazhdueshëm me ujë i konsumatorëve, si dhe bartjen dhe trajtimin e ujërave të ndotura në zonen e vendbanimit Krruç.

Infrastruktura komunale nga paragrafi 1 i këtij neni përbën një tërësi unike dhe të pandashme me infrastrukturën komunale e cila do të ndërtohet në vendbanimet Dobra Voda, Veliki Pijesak dhe Utjeha në Komunën e Tivarit.

Neni 2

Komuna e Ulqinit është dakord që Qeveria e Malit të Zi të sigurojë ndërtimin e infrastrukturës komunale dhe kryejë veprimtaritë komunale të furnizimit me ujë publik dhe administrimin e ujërave të zeza në vendbanimin Krruç.

Neni 3

Pas hartimit të dokumentacionit projektues dhe elaboratit përkatës mbi shpronësimin dhe përcaktimin e servitutit, përkatësisht pas përcaktimit të interesit publik për ndërtimin e infrastrukturës komunale në vendbanimin Krruç, Komuna e Ulqinit padundshmëritë që i disponon, e në të cilat është planifikuar ndërtimi i infrastrukturës së përmendur, në pajtim me Ligjin mbi pronën shtetërore, do t'ia cedojë (lëshojë) Qeverisë, për të cilën gjë do të nxirret një vendim i posaçëm.

Neni 4

Autorizohet Kryetari i Komunës që me Komunën e Tivarit të nënshkruajë Marrëveshjen mbi cedimin e përbashkët Qeverisë së Malit të Zi ndërtimin dhe kryerjen e veprimtarive komunale të furnizimit me ujë publik dhe administrimin e ujërave të zeza për nevojat e shfrytëzuesve në vendbanimin Krruç në Ulqin dhe vendbanimet Dobra Voda, Veliki Pijesak dhe Utjeha në Komunën e Tivarit.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e tetë pas botimit në "Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës".

Numër: _____
Ulqim, më ____ . ____ . 2020

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

Kryetari,
Dr. Ilir Çapuni

Arsyetim

Bazën juridike për nxjerrjen e Vendimit për dhënien e pëlqimit Qeverisë së Malit të Zi për sigurimin e ndërtimit dhe kryerjen e veprimtarive komunale të furnizimit publik me ujë dhe administrimin e ujërave të zeza në vendbanimin Krruç, Dobra voda, Veliki Pijesak dhe Utjeha e përmbajnë:

- neni 186 i Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Fl. zyr. MZ", nr. 2/18, 34/19 dhe 38/20) me të cilin është parashikuar që në kryerjen e punëve nga kompetencat e veta, komunat mund, sipas parimit të vullnetarizmit dhe solidaritetit të bashkëpunojnë dhe të bashkojnë mjetet për kryerjen e punëve me interes të përbashkët, me qëllim të plotësimit të nevojave të popullatës lokale;
- dispozita e nenit 28 Ligjit për veprimtaritë komunale ("Fl. zyr. MZ", nr. 55/16, 74/16, 2/18, 40/19, 66/19) me të cilin është parashikuar që nëse njësitë e vetëqeverisjes lokale nuk kanë mundësi që të ndërtojnë dhe/ose mirëmbajnë infrastrukturën komunale, e cila përbën një tërësi unike dhe të pandarë, dhe e cila gjendet në territorin e dy apo më shumë njësive të vetëqeverisjes lokale, ndërtimin dhe/ose mirëmbajtjen e saj e siguron Qeveria në pajtim me Ligjin, në të cilin rast Qeveria mund të sigurojë kryerjen e veprimtarive komunale përmes një shoqërie ekonomike nga neni 20, paragrafi 1, alinea 3 dhe 4 e këtij ligji dhe
- neni 178 i Statutit të Komunës së Ulqinit ("Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës", nr. 48/19) me të cilin është parashikuar që në kryerjen e punëve nga kompetencat e veta, komuna bashkëpunon me komunat e tjera në pajtim me ligjin dhe se vendimet për të gjitha format e bashkëpunimit dhe bashkimit i sjell Kuvendi i Komunës.

Po ashtu, me nenin 20, paragrafi 1, alinea 3 të Ligjit për veprimtaritë komunale ("Fl. zyr. MZ", nr. 55/16, 74/16, 2/18, 40/19, 66/19) është parashikuar që veprimtaritë komunale mund t'i kryejë një "shoqëri ekonomike me cilësi të personit juridik me shumicë pronësi e shtetit të cilat e themelon Qeveria", kurse me nenin 29, paragrafi 1 të po këtij ligji është parashikuar që interesi publik sigurohet me kryerjen e veprimtarive komunale në atë mënyrë dhe kushtet që janë përcaktuar me këtë ligj, vendimet e njësisë së vetëqeverisjes lokale, përkatësisht Qeverisë dhe kontratë.

Vendbanimi Krruç, si dhe vendbanimet që gravitojnë në këtë zonë me dokumente planifikuese janë përcaktuar si zona për të cilat si dedikim parësor është turizmi dhe banimi. Në këtë zonë janë ndërtuar një numër i madh i objekteve të banimit dhe turistike. Duke pasur parasysh për sa më sipër, një prej parakushteve themelore për një zhvillim të mëtutejshëm planifikuar të kësaj zone është ndërtimi i infrastrukturës komunale lokale, e posaçërisht furnizimi me ujë publik, bartja dhe trajtimi i ujërave të zeza. Ndërtimi i infrastrukturës komunale që mungon në vendbanimet e përmendura paraqet një projekt me rëndësi të posaçme si për banorët e kësaj zone, ashtu edhe për turistët dhe investitorët potencialë.

Konstatimet e përmendura vlejné edhe për vendbanimet Dobra Voda, Veliki Pijesak dhe Utjeha në territorin e Komunës së Tivarit, të cilët me vendbanimin Krruç përbëjnë një tërësi unike dhe të pandarë funksionale në aspektin hapësinor dhe sipas çështjes së ndërtimit të infrastrukturës së planifikuar komunale që mungon. Me qëllim të sigurimit të kryerjes së veprimtarive komunale dhe obligimi i mbrojtjes së mjedisit, Komuna e Ulqinit këtë zonë e vlerëson me përparësi, por nuk ka mundësi që vetëm, e as në bashkëpunim me Komunën e Tivarit, të sigurojë mjetet e nevojshme financiare për këtë projekt.

Me Memorandumin për bashkëpunim nr. 01 – 475/20 të datës 05. 03. 2020 i lidhur në mes Komunës së Ulqinit dhe NP "Ujësjellësi regjional Bregdeti i Malit të Zi" Budvë, me të cilin është shprehur qëllimi, ka qëllim realizimin e projektit për ndërtimin e infrastrukturës komunale me sistemin përkatës të ujërave të zeza të këtyre vendbanime, NP "Ujësjellësi regjional Bregdeti i Malit të Zi" e ka marrë

obligim që pas besimit të punëve të ndërtimit dhe administrimit me infrastrukturën në fjalë nga ana e Qeverisë së Malit të Zi, të lidhë kontratë me Bankën Botërore për rindërtim dhe zhvillim në shumën prej 12 milion Euro. Për ato qëllime Qeveria e Malit të Zi ka parashikuar lëshimin e një letre për konfirmimin e garancioneve shtetërore në pajtim me Ligjin për Buxhet për vitin 2020, në kuadër të kështit të dytë të përkrahjes kreditore në shumën prej 24 milion Euro, pikërisht për realizimin e infrastrukturës komunale të përmendur për vendbanimet Krruç, Dobra Voda, Veliki Pijesak dhe Utjeha.

Është me rëndësi të theksohet që zgjidhjes së kësaj sfide infrastrukturore do t'i qaset në mënyrë të plotë, njëkohësisht me ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, me ndërtimin e impiantit të përshtatshëm për trajtimin e ujërave të zeza për vendbanimet e përmendura, gjë që do të vendosë standarde të reja në ndërtimin e projekteve infrastrukturore, sepse për të parën herë njëkohësisht do të ndërtohet rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit me impiantin për trajtimin e ujërave të zeza për disa mijë objekte të ndërtuara për banim në këtë zonë të komunave Ulqin dhe Tivar.

Në lidhje me këtë, në këtë moment, zbatimi i nenit 28 të Ligjit për veprimtaritë komunale dhe transferimin e obligimit të ndërtimit dhe administrimit me infrastrukturën komunale dhe impiantin për trajtimin e ujërave të zeza Qeverisë së Malit të Zi për vendbanimet e përmendura, paraqet një zgjidhje të qëndrueshme dhe optimale e cila Komunës së Ulqinit do t'i mundësojë zgjidhjen e një çështjeje zhvillimore shumëvjeçare me interes për bashkësinë e gjërë shoqërore, e përmes zhvillimit të përshtetshëm të projekteve prestigjioze të turizmit.

Në pajtim për sa u tha, Komuna e Ulqinit dhe Komuna e Tivarit do të lidhin një Kontratë për transferimin e përbashkët Qeverisë së Malit të Zi të ndërtimit dhe kryerjen e veprimtarive komunale të furnizimit me ujë publik dhe administrimin e ujërave të zeza për nevojat e shfrytëzuesve të vendbanimeve Dobra Voda, Veliki Pijesak dhe Utjeha në Komunën e Tivarit dhe Krruç në Komunën e Ulqinit.

Për të gjitha arsyet e përmendura, i propozohet Kuvendit që ta miratojë Vendimin në fjalë.

Në bazë të nenit 186 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ("Fl. zyr. MZ", nr. 2/18, 34/19 dhe 38/20), nenit 28 të Ligjit për veprimtaritë komunale ("Fl. zyr. MZ", nr. 55/16, 74/16, 2/18, 40/19, 66/19), nenit 155 të Statutit të Komunës së Tivarit ("Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës", nr. 48/19) dhe nenit 178 të Statutit të Komunës së Ulqinit ("Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës", nr. 37/18), dhe nenit 4 të Vendimit për dhënien e pëlqimit Qeverisë së Malit të Zi për ndërtimin dhe kryerjen e veprimtarive komunale të furnizimit me ujë publik dhe administrimin e ujërave të zeza për nevojat e shfrytëzuesve të vendbanimeve Dobra Voda, Veliki Pijesak dhe Utjeha në Komunën e Tivarit ("Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës", nr. ___/___) dhe nenit 4 të Vendimit për dhënien e pëlqimit Qeverisë së Malit të Zi për ndërtimin dhe kryerjen e veprimtarive komunale të furnizimit me ujë publik dhe administrimin e ujërave të zeza për nevojat e shfrytëzuesve të vendbanim Krruç në Komunën e Ulqinit ("Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës", nr. ___/___), e në lidhje me nenin 19 paragrafi 2 të Ligjit për furnizimin regjional me ujë të Bregdetit të Malit të Zi ("Fl. zyr. MZ", nr. 56/16) Komuna e Tivarit, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës Dushan Raiçević dhe Komuna e Ulqinit, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës Loro Nrekiq, me qëllim të realizimit të ndërtimit të infrastrukturës hidroteknike në zonat rurale e me qëllim të plotësimit të nevojave me interes publik, me qëndrueshmërinë Buxhetore të Komunës së Tivarit dhe Ulqinit, më ____ . ____ . _____ lidhën:

MARRËVESHJE

për transferimin e përbashkët Qeverisë së Malit të Zi ndërtimin dhe kryerjen e veprimtarive komunale të furnizimit me ujë publik dhe administrimin e ujërave të zeza për nevojat e shfrytëzuesve të vendbanimeve Dobra Voda, Veliki Pijesak dhe Utjeha në Komunën e Tivarit dhe Krruç në Komunën e Ulqinit

Neni 1

Nënshkruesit e kësaj Marrëveshjeje bien dakord që ekziston problemi shumëvjeçar sa i përket furnizimit me ujë, bartjes dhe spastrimit të ujërave të zeza në vendbanimet Dobra Voda, Veliki Pijesak dhe Utjeha në komunën e Tivarit dhe në vendbanimin Krruç në Komunën e Ulqinit. Sistemi i infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit me sistemin përkatës për trajtimin e ujërave të zeza në vendbanimet e përmendura paraqet një tërësi unike funksionale e cila shërben për nevojat e popullatës lokale në Komunën e Tivarit dhe Komunën e Ulqinit.

Neni 2

Duke shqyrtuar mundësinë e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës komunale të domosdoshme ose kryerjen e përbashkët të veprimtarive komunale në zonën e përmendur, vlera e të cilës është vlerësuar në 12 milionë euro, komunat e Tivarit dhe Ulqinit konstatojnë që nuk kanë mundësi që të ndërtojnë dhe administrojnë me infrastrukturën komunale as të pavarura e as me kryerjen e përbashkët të veprimtarive komunale.

Neni 3

Duke pasur parasysh që nëpër vendbanimet e përmendura është ndërtuar infrastruktura të cilën e administron SHPK "Regionalni vodovod Crnogorskog primorja", janë pjekur kushtet që njësitë e vetëqeverisjes lokale të Tivarit dhe Ulqinit të fillojnë iniciativën për sigurimin e furnizimit të rregullt dhe të vazhdueshëm me ujë të konsumatorëve me ujë cilësor për pije, si dhe shërbimet e bartjes së ujërave të zeza, në bashkëpunim me këtë ndërmarrje në pronësi të Shtetit të Malit të Zi. SHPK "Regionalni vodovod Crnogorsko primorje" do të jetë përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të përmendura, gjë që është definuar me Memorandumin për bashkëpunim, nr. 01-018/20-566 të datës 28. 02. 2020, lidhur në mes Komunës së Zivarit dhe NP "Regionalni vodovod Crnogorsko primorje"

dhe Memorandumit e bashkëpunimit, nr. 01-475/20-1 të datës 05. 03. 2020 lidhur në mes Komunës së Ulqinit dhe NP "Regionalni vodovod Crnogorsko primorje".

Komuna e Tivarit dhe Komuna e Ulqinit konfirmojnë qëllimin që SHPK "Regionalni vodovod Crnogorsko primorje" Budvë, e pas besimit të punëve të ndërtimit dhe administrimit me infrastrukturën në fjalë nga ana e Qeverisë së Malit të Zi, të lidhë kontratë për kredi me Bankën Europiane dhe Rindërtim dhe Zhvillim në shumën prej 12.000.000,00 Euro për të cilin Qeveria e Malit të Zi ka paraparë dhënien e garancive shtetërore në pajtim me Ligjin për buxhetin e vitit 2020.

Neni 4

Njësitë e vetëqeverisjes lokale Tivar dhe Ulqin në pajtim me dispozitat e Ligjit për veprimtaritë komunale veç e veç kanë nxjerrë vendimet për dhënien e pëlqimit Qeverisë së Malit të Zi për sigurimin e ndërtimit dhe kryerjes së veprimtarive komunale të furnizimit me ujë publik dhe administrimin e ujërave të zeza në vendbanimet Dobra Voda, Veliki Pijesak dhe Utjeha, në territorin e Komunës së Tivarit dhe në vendbanimin Kruç në territorin e Komunës së Ulqinit.

Dhënia Qeverisë së Malit të Zi e obligimit të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të zeza për vendbanimet e përmendura, paraqet një zgjidhje të qëndrueshme dhe optimale e cila do t'u sigurojë komunave Tivar dhe Ulqin zgjidhjen e një problemi shumëvjeçar të mungesës së supozimeve infrastrukturore të komunitetit të gjerë, si përmes ngritjes së cilësisë së jetesës të popullatës lokale, ashtu edhe përmes zhvillimit të përshpejtuar të projekteve prestigjoze turistike të cilët do të realizohen në territorin e Komunës së Tivarit dhe Komunës së Ulqinit.

Neni 5

Komunat Tivar dhe Ulqin patundshmëritë e veta të domosdoshme për realizimin e projektit në pajtim me Ligjin për pronën shtetërore do t'ia dorëzojnë Qeverisë së Malit të Zi, për të cilën gjë kuvendet e komunave do të nxjerrin vendime të veçanta për transferim Qeverisë së Malit të Zi.

Neni 6

Nënshkruesit e kësaj marrëveshjeje do të ndërmarrin të gjitha masat dhe veprimet nga kompetencat e veta për realizimin e përshpejtuar të projektit nga kjo Marrëveshje.

Neni 7

Kjo marrëveshje është hartuar në 4 kopje, prej të cilave secila palë nënshkruese mban nga 2 kopje për përdorimin e vet.

Komuna e Tivarit
Kryetari
Dushan Raiçević

Komuna e Ulqinit
Kryetari
Loro Nrekiq